



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINSTRAVE**

V E N D I M

Nr.445, datë 03.06.2020

PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.780, DATË 6.11.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR CAKTIMIN E OFICERËVE KOORDINUES
PËR ÇËSHTJET E DIASPORËS SHQIPTARE NË KONSULLATAT
SHQIPTARE NË ITALI DHE GREQI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, të ligjit nr.23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 4, të vendimit nr.780, datë 6.11.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Përjashtimisht, për vitin 2020, efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Diasporës.”.
2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO